

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 29</i>

28.01.2026

Aplikacioni i KOSTT për azhurnimet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2026

Arsyeshmëri për kërkesat dhe ndryshimet operative dhe kapitale

Janar 2026

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 29</i>

Përmbajtja

Lista e Tabelave.....	3
1.0 Hyrje.....	4
2.0 Të Hyrat.....	4
3.0 Shpenzimet	5
3.1 Mirëmbajtja dhe shpenzimet tjera operative.....	5
3.2 Shpenzimet e Humbjeve në Transmision.....	5
3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Ndihmëse	5
3.4 Mekanizmi ITC.....	9
4.0 Fondi për BRE.....	9
5.0 Arsyeshmëria për projektet e mos realizuara sipas Planit Investiv 2018-2022 - kërkesë për projekte të reja	10
5.1 Arsyeshmëria shtesë për projekte	Error! Bookmark not defined.
5.2 Kërkesë për Projekt të ri: Aplikacioni online për punësim	Error! Bookmark not defined.
6.0 Përmbyllje	Error! Bookmark not defined.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 29</i>

Lista e Tabelave

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara të KOSTT në vitin kalendarik 2025

Tabela 2. Kosto e kapacitetit ne realizim për shërbime ndihmëse për vitin 2026

Tabela 3. Çmimet e parashikuara të rezerves për vitin 2026

Tabela 4. Të hyrat dhe shpenzimet e Mekanizmit ITC gjatë vitit 2025

Tabela 5. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit për BRE gjatë vitit 2025

Tabela 6. Aplikimi i KOSTT për MAR 2026

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 29</i>

1.0 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me datën 12 Dhjetor 2025 ka hapur procesin e azhurnimeve vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për operatorët e rregulluar për vitin 2026 duke u bazuar në Rregullat për të hyrat e lejuara të të licencuarve.

KOSTT në vazhdim ka paraqitur të dhënat për kostot dhe të hyrat e realizuara për vitin 2025 si dhe kërkesat dhe parashikimet për vitin 2026.

Të dhënat e realizuara janë paraqitur sipas vitit kalendarik, të realizuara për 12 muaj.

2.0 Të Hyrat

Në bazë të Vendimit të Bordit të ZRrE-së, me nr. V_2696_2025 të datës 11.04.2025, të Hyrat e Lejuara për vitin relevant tarifar 2025 për KOSTT kanë qenë 88,198,071 euro, kurse janë realizuar 119,363,650 euro.

Në tabelën 1 mund të shihen të dhënat për të hyrat e lejuara dhe të realizuara për vitin kalendarik 2025.

Tabela 1. Të Hyrat e Lejuara dhe të Realizuara të KOSTT në vitin kalendarik 2025

Të Hyrat 2025	Njësia	Parashikimi	Realizimi	%
Të hyrat nga 400/220 kV	€000s	100.08	120.55	120%
Të hyrat nga 110 kV	€000s	7,032.09	12,133.04	173%
Të hyrat nga SO	€000s	63,471.22	51,265.68	81%
Të hyrat nga MO	€000s	251.16	255.59	102%
Të hyrat nga BRE	€000s	17,343.53	55,588.79	321%
Të Hyrat pa BRE	€000s	70,854.54	63,774.86	90%
Total të Hyrat	€000s	88,198.07	119,363.650	135%

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 5 nga 29</i>

3.0 Shpenzimet

Në vazhdim paraqiten të dhënat për shpenzimet e realizuara 2025 si dhe parashikimet për vitin 2026.

3.1 Mirëmbajtja dhe shpenzimet tjera operative

Në vitin 2025 për kategorinë e Shpenzimeve operative kanë qenë të lejuara 7,857,298.031 euro, ndërsa janë realizuar 9,157,650.11 euro. Për kategorinë e mirëmbajtjes kanë qenë të lejuara 686,201.123 euro kurse janë realizuar 766,338.41 euro. Për shpenzime tjera operative vlera e lejuar ishte 7,055,139.637 euro, ndërsa vlera e realizuar është 8,274,652.30 euro. Kurse sa i përket kategorisë ligjore të shpenzimeve për sigurim shëndetësor si OPEX i pakontrollueshëm, të lejuara ishin 115,957.27 euro kurse janë realizuar 116,659.39 euro. Realizimi në nivel më të lartë se sa ai i lejuar vjen si pasojë kryesisht e rritjes së çmimeve në treg dhe faktorë të tjerë jashtë kontrollit të kompanisë. Kërkesa e KOSTT për vitin 2026 është bazuar në vlerën e realizuar në vitin 2025.

3.2 Shpenzimet e Humbjeve në Transmision

Gjendja aktuale sa i përket kostos së humbjeve në transmision është si vijon. Niveli i realizuar i humbjeve në transmision është 135.4 GWh i shprehur në vlerë financiare 14,590,200.19 euro.

Humbjet e parashikuara për vitin 2026 sipas Bilancit Elektroenergjetik janë 128.4 GWh kurse kostoja e parashikuar e këtyre humbjeve është 15,763,894.85 euro. Kalkulimi i kësaj vlere është bërë bazuar në çmimin mesatar të planifikuar që është 122.72 €/MWh.

3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Ndhmëse

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, KOSTT menaxhon dhe operon me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike të Kosovës. Sipas Nenit 16 të këtij ligji ndër detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit është: “prokurimi i shërbimeve balancuese për balancim të sistemit, në bazë të parimeve të tregut dhe parimeve të transparencës dhe jo-diskriminimit”. Gjithnjë sipas Ligjit për Energjinë Elektrike (Neni 19), Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të angazhohet në prokurimin e energjisë dhe kapacitetit, bazuar në procedura transparente, jo-diskriminuese dhe të bazuara në treg për qëllimet e balancimit të sistemit dhe ofrimit të shërbimeve ndihmëse.

Sipas Licencës (Neni 19) për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, i licencuari (KOSTT) do të jetë përgjegjës për aranzhimin e provizioneve të sasive dhe llojeve të shërbimeve ndihmëse, prokurimin e tyre në përputhje me ligjin për energjinë elektrike dhe

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 6 nga 29</i>

procedurat për prokurim, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë që të licencuarit t'i mundësohet kryerja e obligimeve të dhëna sipas Kodit të Rrjetit, si dhe obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Kyçjes KOSTT-ENTSO-E.

Bazuar në Ligjin për Energjinë Elektrike (Neni 22), KOSTT ka përgatitur Procedurën për Tregtimin e Energjisë Elektrike, e cila është miratuar nga ZRRE, në të cilën janë përcaktuar parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

Në pajtim me Procedurën për Tregtimin e Energjisë elektrike të miratuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, KOSTT është i obliguar të bëjë prokurimin për këto shërbime ndihmëse në tregun e energjisë elektrike nga ofruesit e shërbimeve të cilët i plotësojnë kushtet administrative dhe teknike për të ofruar shërbimin e Rezervës aFRR dhe mFRR.

KOSTT, si Operator i Sistemit dhe Transmetimit, është i pajisur me licencën e lëshuar nga ZRRE për operimin teknik të rrjetit të transmetimit dhe operimin e sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të detyrave për operimin e sistemit, KOSTT është i obliguar që në përputhje me Kodin e Rrjetit në fuqi, të sigurojë operimin efikas të sistemit në kohë reale, duke balancuar SEE gjatë gjithë vitit, konkretisht çdo moment brenda 8760 orëve të vitit kalendarik. Balancimi në fjalë është i domosdoshëm për mundësimin e punës paralele me rrjetet e transmetimit të shteteve fqinje dhe atyre Evropiane. Që kjo të arrihet është detyrë licensore e KOSTT që të siguroi produktet balancuese, konkretisht shërbimet ndihmëse si rregullimi sekondar aFRR dhe rregullimin terciar mFRR, përmes të cilave produkte do të jetë në gjendje të balancoi SEE të Republikës së Kosovës në kohë reale.

Kjo do të thotë që në Zonën e Kontrollit të KOSTT-it, në çdo moment gjenerimi i energjisë elektrike (shtuar edhe importin) duhet të jetë në balancë me konsumin e energjisë elektrike (shtuar edhe eksportin). Me fjalë të tjera diferenca në mes të këtyre dy komponentëve: (gjenerimi + importi) si dhe (konsumi + eksporti) të jete plotësisht i balancuar.

Gjithashtu, bazuar në direktivat dhe rregullativat e ENTSO-E siç janë SOGL (System Operation Guideline), EB (Electricity Balancing Network Code), NC LFCR (Network Code Load - Frequency Control and Reserves) etj., të cilat definojnë kushtet e domosdoshme për punë paralele interkonektive, secili Operator i Sistemit të Transmetimit obligohet që të balancojë sistemin e transmetimit në Zonën e vet të Kontrollit.

Aktualisht KOSTT në përputhje me Marrëveshjen e Kyçjes me RGCE\ENTSO-E, është duke operuar si LFC Zonë e pavarur. Në kontekst të kësaj, ENTSO-E në vazhdimësi do të monitorojë përmbushjen e kushteve teknike të KOSTT për operim të pavarur si LFC Zonë (LFC Area).

Një nga kërkesat me prioritet të lartë është siguri i shërbimeve ndihmëse për të balancuar sistemin elektroenergjetik të Kosovës në kohë reale.

Bazuar në përshkrimet e cekura më lart KOSTT obligohet që të sigurojë blerjen e shërbimeve ndihmëse për balancimin e sistemit, konkretisht:

1. Rregullimin terciar (+/- mFRR Manual Frequency Restoration Reserves):

KOSTT është i obliguar të sigurojë rregullimin terciarë për ngritje (+mFRR – marrje Manual Frequency Restoration Reserves) në vlerën +197 MW dhe

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 29</i>

rregullimin terciarë për zbritje (-mFRR – dhënie Manual Frequency Restoration Reserves) në vlerën -50 MW, sasi këto që nevojiten për balancimin e SEE të Kosovës me rastin e paraqitjes së mungesave dhe tepricave të en.el. në SEE të Kosovës.

Në kontekst të përmbushjes së obligimeve që dalin nga marrëveshja e kyçjes KOSTT - ENTSO-E për balancimin e sistemit në kohë reale, KOSTT duhet të siguroj rezervat balancuese për tërë vitin 2026, në përputhje me buxhetin e planifikuar të KOSTT për vitin 2026, i cili pritët të miratohet edhe nga ZRRE.

Buxheti i planifikuar për vitin 2026 për shërbimet ndihmëse është paraparë në vlerë prej 45,000,168.72 €.

Bazuar në Rregullën e OST/OT, kostot e lejuara të shërbimeve ndihmëse dhe balancuese për vitin 2026 do të propozohen nga OST/OT gjatë shqyrtimeve periodike dhe gjatë përshtatjeve të rregullta, duke përdorur parashikimin e OST/OT për blerjet e nevojshme të shërbimeve nga aspekti sasior dhe financiar.

Parashikimi i këtyre blerjeve të nevojshme dhe çmimeve do të mbështetet me dëshmitë e nevojshme, duke përfshirë këtu edhe marrëveshjet e dakorduara për shërbime ndihmëse nga OST.

Rregullatori do të përcaktojë kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse, duke marrë parasysh propozimin e lartpërmendur, pas vlerësimit të dëshmive të ofruara për nevojën dhe koston e këtyre shërbimeve. Gjatë këtij vlerësimi, ZRRE do të shqyrtojë nëse këto shërbime ndihmëse i janë nënshtruar prokurimit konkurrues apo do të marrë parasysh ndonjë dëshmi tjetër që mund të sigurohet për të treguar se prokurimi i këtyre shërbimeve është bërë mbi bazë ekonomike.

Kalkulimi për kostot e kapacitetit për rregullimin terciar mFRR në ngritje (+197 MW) dhe zbritje të kapacitetit prej (-50 MW), si dhe rregullim sekondar aFRR (+/-40 MW) (Automatic Frequency Restoration Reserves), është paraqitur në tabelën e mëposhtme

Tabela 2. Kosto e kapacitetit në realizim për shërbime ndihmëse për vitin 2026

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 29</i>

Kostoja e kapacitetit të planifikuar për shërbimin ndihmës aFRR (±40 MW), dhe Kostoja e kontraktuar mFRR me KESH në ngritje (+197 MW) dhe në zbritje (-50 MW) për vitin 2026.							
Muaji	kapaciteti (MW)	ditë/muaj	aFRR ngritje 70 €/MW	aFRR zbritje 81.255 €/MW	mFRR ngritje 5.38 €/MW PL	mFRR zbritje 2.567 €/MW PL	Gjithsej
Janar	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	861,819.84 €	100,440.00 €	3,900,386.84 €
Shkurt	40.0	28	1,309,728.00 €	1,344,000.00 €	778,417.92 €	98,112.00 €	3,530,325.92 €
Mars	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	882,339.36 €	119,040.00 €	3,939,506.36 €
Prill	40.0	30	1,403,280.00 €	1,440,000.00 €	866,642.40 €	116,280.00 €	3,826,272.40 €
Maj	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	895,530.48 €	120,156.00 €	3,953,813.48 €
Qershor	40.0	30	1,403,280.00 €	1,440,000.00 €	609,912.00 €	71,640.00 €	3,524,902.00 €
Korrik	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	639,036.48 €	74,028.00 €	3,651,191.48 €
Gusht	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	669,815.76 €	74,028.00 €	3,681,970.76 €
Shtator	40.0	30	1,403,280.00 €	1,440,000.00 €	558,849.60 €	71,640.00 €	3,473,839.60 €
Tetor	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	825,177.84 €	88,164.00 €	3,851,468.84 €
Nëntor	40.0	30	1,403,280.00 €	1,440,000.00 €	834,019.20 €	91,440.00 €	3,768,809.20 €
Dhjetor	40.0	31	1,450,056.00 €	1,488,000.00 €	861,819.84 €	98,580.00 €	3,898,526.84 €
Total			17,073,240.00 €	17,520,000.00 €	9,283,380.72 €	1,123,548.00 €	45,000,168.72 €

Tabela 3. Çmimet e parashikuara të rezervës për vitin 2026

Çmime të parashikuara për Planifikim të rezervës - 2026			
aFRR+ [çmimi €]	aFRR- [çmimi €]	mFRR+ [çmimi €]	mFRR- [çmimi €]
48.725	50.00	5.88	2.70
48.725	50.00	5.88	2.92
48.725	50.00	6.02	3.20
48.725	50.00	6.11	3.23
48.725	50.00	6.11	3.23
48.725	50.00	4.30	1.99
48.725	50.00	4.36	1.99
48.725	50.00	4.57	1.99
48.725	50.00	3.94	1.99
48.725	50.00	5.63	2.37
48.725	50.00	5.88	2.54
48.725	50.00	5.88	2.65

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 9 nga 29</i>

Për vitin 2025 për shpenzimet e shërbimeve ndihmëse janë lejuar 37,716,434 euro kurse janë realizuar 39,640,360.93 euro, si pasojë e nevojës për aktivizimin e shërbimeve ndihmëse si pasojë e jobalancave nga mungesa e prodhimit dhe furnizimit.

3.4 Mekanizmi ITC

Gjatë vitit 2025 të hyrat nga mekanizmi ITC ishin 466,876.26 euro kurse shpenzimet 1,354,746.57 euro, që e vendos KOSTT-in në pozicion neto negativ (887,870.31) euro. Planifikimi për vitin 2026 mbetet sipas planifikimeve të periudhës pesëvjeçare.

Tabela 4. Të hyrat dhe shpenzimet e Mekanizmit ITC gjatë vitit 2025

2025	Njësia	Të Hyrat	Shpenzimet	Mbetja
Mekanizmi ITC	€000s	466,876.26	1,354,746.57	(887,870.3)

4.0 Fondi për BRE

Bazuar në legjislacionin që mbulon fushën e energjisë Operatori i Tregut është menaxhues i Fondit për BRE. Llogaritjet për realizimet dhe parashikimet për këtë fond janë paraqitur në Modelin për Përshtatjet e Rregullta Vjetore. Vlera e estimuar për vitin 2026 është 18,675,517.32 euro ku përfshihet ndryshimi në mes të tarifave nxitëse dhe çmimit mesatar i vitit 2025, kosto e imbalancit 1,904,734.02 euro si dhe kosto e menaxhimit të fondit që është llogaritur rreth 1% e këtij fondi.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet e realizuara të Fondit për BRE për vitin 2025. Të njëjtat do të përcillen edhe në formatin Excel.

Tabela 5. Të hyrat dhe shpenzimet e Fondit për BRE gjatë vitit 2025

2025	Njësia	Të Hyrat	Shpenzimet	Mbetja
Fondi për BRE	€000s	55,588,786.46	49,951,849.47	5,636,937.0

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 29</i>

5.0 Arsyeshmëria për ndryshimet e Planit Investiv 2018 - 2022

5.1 Kërkesë për projekte të reja

Gjatë procesit të shqyrtimit të të hyrave pesëvjeçare 2023-2027, në raport me kërkesat e paraqitura për projekte kapitale KOSTT-it i janë aprovuar vetëm 50% e vlerës së kërkuar. Duke marrë parasysh natyrën dinamike të rrjetit të transmetimit si dhe nevojat dhe kërkesat si teknike ashtu edhe ligjore, rregullative dhe kontraktuale, KOSTT në vazhdim paraqet kërkesën për përfshirjen e shtatë projekteve të reja në këtë periudhë pesëvjeçare dhe ndryshimin e burimit të financimit për një projekt. Duhet theksuar se të gjitha këto projekte janë të aprovuara me Planin Zhvillimor Dhjetëvjeçar. Kërkesa e KOSTT është që të përfshihen në Planin Zhvillimor dhe Investiv Pesëvjeçar si realizim në vitin 2027.

Për financimin e këtyre projekteve KOSTT është në bisedime me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim të cilët janë të gatshëm të mbështesin KOSTT-in në këtë fazë të rëndësishme të zhvillimit me një kredi të butë.

Në vazhdim janë paraqitur arsyetimet për projektet në fjalë.

Projektet:

- **NS Klina: Rehabilitimi i nënstacionit së bashku me instalimin e transformatorit të dytë TR2 110/10(20) kV, 40MVA, Vlera e projektit është 4,067,796.61 €**
- **NS Gjilani 5 - Instalimi i transformatorit të dytë TR2 110/10(20) kV, 40MVA, Vlera e projektit është 1,610,169.49 €**

Nënstacionet NS Klina dhe NS Gjilani 5 aktualisht operojnë me vetëm një transformator. Operimi me vetëm një transformator paraqet problem të madh për sigurinë e furnizimit në rast të rënies së paplanifikuar të tij. Në zonat ku janë lokalizuar nënstacionet e lartpërmendura nuk ekziston furnizim rezervë (rrjet unazor në tension të mesëm) i cili për raste të tilla për një kohë të shkurtë do të transferonte furnizimin nga rrjeti në prishje në rrjetin e tensionit të mesëm. Nënstacionet që operojnë me vetëm një transformator, vështirësojnë procesin e mirëmbajtjes periodike të transformatorit dhe fushave të tij (110 kV, 35 kV ose 10 kV). Probabiliteti i prishjeve në transformator dhe në fushat e tij ndikohet nga vjetërsia, rrjedhat e fuqisë, lidhjet e shkurta në sistem si dhe nga niveli paraprak i mirëmbajtjes. Shumë paisje apo elemente të sistemit duke përfshirë transformatorët dhe ndërprerësit në nënstacionet 110/35 kV dhe 110/10 kV janë ballafaquar me sforcime të theksuara të shkaktuara nga prishjet/lidhjet e shkurta, në rrjetin 110 kV, të shpeshta në periudhën kohore 1990-2006 kur rrjeti nuk kishte kapacitet të mjaftueshëm të transmetimit dhe transformimit. Prishjet në vet transformator si:

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 29</i>

ne pështjella, apo në rregullatorin e tensionit janë prishje problematike, riparimi i tyre kërkon kohë e ndonjëherë financiarisht nuk e vlen te riparohen. Koha prej momentit te shfaqjes së prishjes e deri te evitimi i problemit, apo zëvendësimi i transformatorit zakonisht mund te jetë me ditë të tëra, andaj demi që do ti shkaktohet konsumatorëve do të jetë i madh ne mungesë të transformatorit te dytë, apo kapaciteteve rezervë për furnizim nga rrjeti i tensionit të mesëm. Sasia e energjisë së padërguar do të jetë shumë e madhe, me efekte negative socio-ekonomike për konsumatorët.

Për të evituar riskun e mos furnizimit të konsumit si rrjedhojë e humbjes/shkqyes së transformatorit të vetëm është më se e nevojshme instalimi i transformatorit të dytë në nënstacionet e lartpërmendura.

Në NS Klina planifikohet të instalohet transformatori i dytë 40 MVA, 110/10(20) kV, krahas transformatorit ekzistues 31.5 MVA, 110/10 kV. Gjithashtu do të instalohen edhe fushat përkatëse transformatorike 110 kV dhe 10(20) kV. Ky projekt do të krijoj kushte për plotësimin e kriterit N-1 në transformim. Ky projekt duhet të sinkronizohet me projektin e Rivitalizimit të dy fushave ekzistuese 110 kV, ashtu që të minimizohet energjia e padërguar te konsumatorët gjatë procesit të implementimit të projektit.

Në NS Gjilani 5 është planifikuar të instalohet transformatori i ri 40 MVA, 110/10(20) kV krahas transformatorit ekzistues 31.5 MVA, 110/10(20) kV, si dhe dy fushat përkatëse të tij 110 kV dhe 10(20) kV. Ky projekt do të krijoj kushte për plotësimin e kriterit N-1 në transformim.

Përfitimet e pritshme nga dy projektet e lartpërmendura janë:

Reduktimi i energjisë së padërguar te konsumatorët të zonës së Klinës dhe Gjilanit

Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit te konsumit të shpërndarjes

Përkrahje për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjetit të shpërndarjes 10(20) kV

Ngritja e kapaciteteve transformuese 110/TM kV dhe plotësimi i kriterit N-1 ne transformim

Optimizimi i procesit të mirëmbajtjes

Përkrahje për zhvillim te sektorit ekonomik/ngarkesës industriale

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	ver. 1.0	faqe 12 nga 29

- **NS Gjakova 1 - Zëvendësimi i transformatorit TR 2 110/35/20 kV, 40MVA, Vlera e projektit është 1,355,932.20 €**
- **NS Gjilani 1 - Zëvendësimi i transformatorit TR 2 110/35/10(20) kV, 40MVA, Vlera e projektit është 1,355,932.20 €**

Arsye kryesore e futjes në listën e projekteve për përf forcim të rrjetit është mosha e transformatorëve dhe ngritja e kapacitetit transformues në dy nënstacionet, Gjilan 1 dhe Gjakova 1.

Në NS Gjakova 1 parashihet ndërrimi i transformatorit të mbetur 20 MVA, 110/35 kV i ndërtuar në vitin 1974 me transformator 110/10(20) kV me fuqi 40 MVA. Me këtë rast arrihet furnizimi me 10(20) kV të konsumit të gjithë qytetit të Gjakovës përmes dy nënstacioneve Gjakova 1 dhe 2.

Rrjeti 35 kV do të mbetet si furnizim rezervë i cili do të jetë i domosdoshëm për furnizimin e mëtutjeshëm të konsumit të Xërxës e cila furnizohet përmes 35 kV edhe nga NS Rahoveci. Ndërlidhja e NS Gjakova 1 dhe NS Rahoveci me linja 35 kV luan një rol të rëndësishëm në mbajtjen e rezervave të rrjetit në raste të avarive të paparashikueshme në dy nënstacionet në fjalë. Në figurën 1 janë paraqitur skemat e thjeshtuara njëpolare të nënstacioneve ku do të bëhet zëvendësimi i transformatorëve.

Përfitimet e pritshme nga dy projektet e lartpërmendura janë:


Reduktimi i energjisë së padërguar të konsumatorët e zonës së Gjilanit dhe Gjakovës,

Ngritja e sigurtisë dhe besueshmërisë së furnizimit të konsumit të shpërndarjes

Përkrahje për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjetit të shpërndarjes 10(20) kV

Ngritja e kapaciteteve transformuese 110/TM kV

Përkrahje për zhvillim të sektorit ekonomik/ngarkesës industriale



	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 29</i>


Figura 1. Zëvendësimi i transformatorëve ne NS Vitia, NS Gjilani 1 dhe NS Gjakova 1, me transformator të ri

- **Zëvendësim i transformatorit TR-2 në NS Prizren 1 (40MVA) dhe TR-1 në NS Viti**
- **NS Prizreni 3 - Zëvendësimi i transformatorit TR 2 110/10(20) kV, 40MVA, Vlera e projektit është 1,355,932.20,**
- **NS Vitia - Zëvendësimi i transformatorit TR1 110/35/10(20)/35 kV, 40MVA Vlera e projektit është, 1,355,932.20**

Ngritja e vazhdueshme e kërkesës në Prizren kërkon ngritje te kapacitetit transformues si dhe evitim të problemeve të sigurisë së furnizimit përmes zëvendësimit të transformatorëve me moshë përtej ciklit nominal jetësor. Për këtë arsye ndërrimi i TR-2, 110/35 kV ne NS Prizreni 1, i ndërtuar ne vitin 1987, me transformatorin e ri 110/10(20) kV, me fuqi 40 MVA është i domosdoshëm. Duke u ndërlidhur me projektin e mëhershëm për ndërrimin e transformatorit TR-1 gjithashtu me transformator tre-pshtjellor, arrihet modernizimi i tre transformatorëve dhe plotësimi i kriterit N-1 për dy nivelet e tensionit 35 kV dhe 10(20) kV. Mbajtja e mëtutjeshme e rrjetit 35 kV arsyetohet me faktin që ekziston ndërlidhje e fuqishme e rrjetit 35 kV që lidhë NS Prizreni 1, me konsumin e Zhurit dhe NS Dragashi i planifikuar për vitin 2026. Kjo ndërlidhje me rrjetin 35 kV krijon kapacitet rezervë në rast të problemeve që mund të shfaqen në NS Prizren 1 apo në NS Dragash.

Në NS Viti parashihet që të zëvendësohet edhe transformatori i mbetur 20 MVA, 110/35 kV i ndërtuar në vitin 1973 me transformator tre-pshtjellor 110/35/10(20) kV me fuqi 40/40/40 MVA. Pas zëvendësimit të dy transformatorëve ne NS Viti, plotësohet kriteri N-1 në të dy nivelet e tensionit 35 kV dhe 10(20) kV. Për shkak të ndërlidhjes unazore me rrjet 35 kV ne mes të NS Vitia dhe NS Gjilani 1, rrjeti 35 kV përveç vazhdimit të furnizimit të ngarkesës në zonat specifike me rrejt 35/10 kV, do të luaj rol të rëndësishëm si kapacitet rezervë për transferimin e fuqisë nga Vitia në Gjilan 1 dhe anasjelltas. Gjithashtu ne rrjetin 35 kV mund të lidhen edhe BRE-të me kapacitet 10-15 MW. Projekti parasheh instalimin e fushës së re transformatorike 10(20) kV

Figura 2. Zëvendësimi i transformatorit TR-2 ne NS Prizren 1 dhe NS Viti




	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 29</i>

- **Zëvendësim i transformatorit TR-1 në NS Prizren 3 (40MVA)**

Arsye kryesore e futjes në listën e projekteve të këtij transformatori është mosha e tij, ngritja e kapacitetit transformues në NS Prizren 3 dhe mundësi i konvertimit të rrjetit 10 kV në 20 kV.

Në NS Prizren 3 110/10 kV parashihet që në vitin 2033 të zëvendësohet transformatori TR-1, 31.5 MVA, 110/10 kV i ndërtuar në vitin 1986 me transformator 110/10(20) kV me fuqi 40 MVA.

Figura 3. Zëvendësimi i transformatorit TR-1 në NS Prizren 3



Përfitimet e pritshme nga dy projektet e lartpërmendura janë:

Reduktimi i energjisë së padërguar te konsumatorët e zonës së Prizrenit.

Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit të konsumit të shpërndarjes

Përkrahje për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjetit të shpërndarjes 10(20) kV dhe reduktimit të humbjeve në rrjet

Ngritja e kapaciteteve transformuese 110/TM kV

Përkrahje për zhvillim të sektorit ekonomik/ngarkesës industriale

Përkrahje e BRE-ve në lidhje të mundshme në rrjetin e tensionit të mesëm

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	ver. 1.0	faqe 15 nga 29

- **Linja e re e njëfishtë kabllore 110kV NS Prizreni 1 - NS Prizreni 2 (me një fushë të linjës në NS Prizreni 1 dhe e kyqur në fushën rezervë në NS Prizreni 2) Vlera e projektit është, 3,644,067.80**

Ngarkesa në rritje të vazhdueshme në rajonin e Prizrenit, do të vë në risk plotësimin e kriterit N-1 për atë pjesë të rrjetit transmetues. Linja e dytë 110 kV nga NS Prizreni 1 në NS Prizreni 2 është e nevojshme pasi që sipas konfiguracionit aktual të rrjetit, rënia e linjës NS Prizren 2- NS Prizreni 3 do të shkaktojë mbingarkesë në linjën NS Prizren 2 - NS Prizreni 1. Projekti parasheh: instalimin e kabllorës nëntokësore 110 kV, XLPE, 1000 mm², me gjatësi rreth 5.2 km dhe instalimin e fushës së re kabllore 110 kV në NS Prizren 1. Në NS Prizren 2 ekziston fusha e kompletuar e linjës (kabllorës) 110 kV.

Shtrirja gjeografike e linjës dyfishtë NS Prizren 2- NS Prizren 1 është paraqitur në figurën 4.

Ky projekt është i rëndësishëm për realizimin e konceptit të grupimit të konsumit 110 kV sipas nënstacioneve kryesore.

Përfitimet e pritshme nga projekti janë:


Ngritja e kapaciteteve transmetuese të rrjetit 110 kV

Plotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në periudhën afatgjatë kohore.

Reduktimi i energjisë së padërguar të konsumatorit

Optimizimi i rrjedhave të fuqisë dhe mundësimi i grupimit të ngarkesave 110 kV sipas furnizimit të pavarur nga nyjet kryesore të sistemit transmetues (në këtë rast nga NS Prizreni 2)

Figura 4 .
Projekti linja kabllor e 110 kV NS Prizren 1- NS Prizren 2



	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	ver. 1.0	faqe 16 nga 29

- **Revitalizimi i linjës 110kV ekzistuese mes NS Prizreni 1 - NS Prizreni 3 (ndërrimi i përçueseve ekzistues, izolatoreve, përçesit mbrojtës, vlerësimi i shtyllave ekzistuese) Vlera e projektit është 1,186,440.68**

Linja NS Prizren 1- NS Prizren 3 aktualisht me seksion 150 mm^2 ka kapacitetin transmetues 83 MVA. Ky kapacitet i linjës është i pamjaftueshëm në plotësimin e kriterit N-1. Kjo linjë shtrihet në pjesën e dendur urbane të qytetit të Prizrenit, andaj zëvendësimi i përçesit me përçues me kapacitet më të lartë dhe peshë të njëjtë duke përdorur përçues të avancuar ACCC 160 mm^2 , paraqet zgjedhjen më optimale. Me këtë arrihet optimizimi i kostove si dhe ngritja e dëshirueshme e kapacitetit të linjave.

Linja paraqet segmentin ndërlidhës për furnizimin e NS Prizreni 3, ashtu siç është treguar në figurën 5. Rivitalizimi i kësaj linje do të ndikoj ndjeshëm në rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë operuese të asaj pjese të rrjetit 110 kV.


Përfitimet e pritshme nga projekti janë:

Plotësimi i kriterit N-1 për pjesën e rrjetit 110 kV që ndërlidhë nënstationet 110 kV në rajonin e Prizrenit

Ngritja e kapacitetit transmetues të linjës nga 83 MVA në 114 MVA

Reduktimi i energjisë së pa furnizuar

Figura 5 Linja 110 kV NS Prizreni 1 – NS Prizreni 3 me gjatësi 4.69 km



	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 29</i>

- **SS Vushtrri 1: rekonstruimi i fushave 110kV (+furnizimi vetanak AC/DC, konverteret, panelet, tokëzimi, SCADA,) Vlera e projektit është 3,220,338.98 €**

NS Vushtrri 1 është një ndër nënstacionet e para të ndërtuara në Kosovë me një konfiguracion i cili nuk siguron selektivitet adekuat të mbrojtjeve rele. Rivitalizimi i këtij nënstacioni është i domosdoshëm nga fakti që në zbarrat e tij 110 kV janë të lidhura 3 linja 110 kV, njëra prej të cilave bartë fuqinë e gjeneruar nga PE Selaci 105 MW. Gjendja teknike e nënstacionit nuk është e kënaqshme dhe si e tillë rrezikon sigurinë e rrjetit 110 kV që ndërlidhë Vushtrri 2, Trepça, Vallaqi dhe Ilirida. Konfiguracioni aktual i NS Vushtrri 1 nuk siguron selektivitet të duhur në rast të prishjeve në njërën nga linjat e lidhura në nënstacion. Dy linjat 110 kV operojnë vetëm përmes ndërprerësit tërthor ashtu siç është paraqitur në figurën 6. Ekzistojnë dy mundësi në përzgjedhjen e teknologjisë së pajisjeve të tensionit të lartë AIS dhe HIS. Teknologjia HIS kërkon hapsirë shumë më të vogël karahasuar me teknologjinë AIS. Në përkeqësimin e gjendjes së sigorisë ka ndikuar edhe avaria në NS Trepça e cila aktualisht është e lidhur në rrjetin 110 kV në konfiguracion të pa favorshëm sa i përket sigorisë së rrjetit. Rivitalizimi i nënstacionit parasheh ndërrimin e pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV, ndërrimin e sistemit të zbarrave dhe portaleve duke ndërtuar sistemin me zbarra të dyfishta dhe me fushë lidhëse. Projekti ndërlidhet me projektin: Rivitalizimi i segmentit të linjës 110 kV NS Bardhi – NS Ilirida- NS Vallaqi me ç’ rast dy fushat e lira të linjave 110 kV do të shfrytëzohen për këtë projekt. Prandaj zhvendosja kohore e Rivitalizimit të NS Vushtrri 1, do të thotë mos kompletim të projektit të lartëpërmendur deri në 2028 për shkak të ndërlidhjes së këtyre do projekteve.

Përfitimet e pritshme nga projekti janë:

Ngritja e sigorisë dhe besueshmërisë së operimit të nënstacionit

Ngritja e sigorisë së operimit të PE Selac


Reduktimi i energjisë së padërguar të konsumatori

Ngritja e sigorisë së operimit të industrisë metalurgjike Trepça

Ngritja e sigorisë së personelit që punon në nënstacion si dhe personelit të mirëmbajtjes

Figura 6 Skema aktuale e NS Vushtrri 1 dhe skema e propozuar e Rivitalizimit

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	ver. 1.0	faqe 18 nga 29



• N

S Vallaq: rekonstruimi i fushave 110kV (5 fusha të linjave + 2 fusha të transformatorëve + fusha lidhëse, zbarrat e dyfishta, furnizimet vetanake) Vlera e projektit është 3,813,559.32 €

NS Vallaqi është një ndër nënstacionet e para të ndërtuara në Kosovë. Rivitalizimi i këtij nënstacioni është i domosdoshëm nga fakti që në zbarrat e tij 110 kV janë të lidhura 5 linja 110 kV, njëra prej të cilave bartë fuqinë e gjeneruar nga HC Ujmani. Gjendja teknike e nënstacionit nuk është e kënaqshme dhe si e tillë rrezikon sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit të konsumatorëve. Rivitalizimi i nënstacionit parasheh ndërrimin e paisjeve të tensionit të lartë 110 kV, ndërrimin e sistemit të zbarrave dhe portaleve duke ndërtuar sistemin me zbarra të dyfishta dhe me fushë lidhëse.

Përfitimet e pritshme nga projekti janë:

Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të nënstacionit

Optimizimi i operimit të nënstacionit pas kalimit në sistem të zbarrave të dyfishta

Reduktimi i energjisë së padërguar të konsumatori

Ngritja e sigurisë së personelit që punon në nënstacion si dhe personelit të mirëmbajtjes

- **NS Burimi: rehabilitimi i nënstacionit (dy fusha të linjave, një fushë e transformatorit dhe sherbimet vetanake), Vlera e projektit është 1,694,915.25 €**

Ndërrimi i tyre me paisje moderne është i rëndësishëm për operim të sigurt të sistemit të transmetimit. Investimi ulë kostot e mirëmbajtjes, dhe ngritë sigurinë dhe besueshmërinë operuese të nënstacioneve përkatëse.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 29</i>

Projekti përfshinë:

Ndërrimi i 2 fushave të linjave 110 kV në NS Burim

Ndërrimi i 1 fushe transformatorike 110 kV, në NS Burim

Rivitalizimi i shërbimeve vetanake

Përfitimet e pritshme të përmbledhura janë si në vijim:

Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së operimit të NS Burimi 110/10 kV

Reduktimi i energjisë së padërguar te konsumatori


Ngritja e sigurisë së personelit që punon në nënstacion si dhe personelit të mirëmbajtjes

Reduktimi i kostove të mirëmbajtjes

- **NS Prishtina 1: zëvendësimi i transformatorit TR 2 (63MVA) Vlera e projektit është 1,355,932.20 €**

Nënstacioni Prishtina 1, operon me dy transformator trepshtjellor: TR1 me fuqi 63 MVA, 110/35/10(20) MVA dhe TR2 me fuqi 63 MVA 110/35/6.6 MVA. Rrjeti 35 kV aktualisht furnizon konsumin e Fushë Kosovës (pjesërisht 70%), Mazgitin si dhe nënstacionet 35/10 kV në Prishtinë. Pas ndërtimit të NS Fushë Kosova ngarkesa në pështjellat 35 kV të dy transformatorëve do të reduktohet ndieshëm. Sipas informacioneve nga KEDS ky nënstacion nuk plotëson plotësisht kriterin N-1 në nivelin 10 (20) kV, çka vënë në rrezik sigurinë e furnizimit të kësaj pjese të konsumit. Zëvendësimi i transformatorit TR2 me transformator të ri 63 MVA, 110/35/10(20) kV mundëson ngritjen e sigurisë për rrjetin 10(20) kV për kryeqytetin.

Figura 7. Zëvendësimi i transformatorit T2 në NS Prishtina 1



Përfitimet e pritshme nga projekti janë:

Plotësimi i kriterit N-1 për rrjetin 10(20) kV që furnizohet nga ky nënstacion

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	ver. 1.0	faqe 20 nga 29

Reduktimi i energjisë së padërguar te konsumatorët.

Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit te konsumit të shpërndarjes

Përkrahje për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjetit të shpërndarjes 10(20) kV

Përkrahje për zhvillim te sektorit ekonomik/ngarkesës industriale


- Zëvendësim i transformatorit TR-1 në NS Gjakova 2 (40MVA) dhe TR-2 në NS Skenderaj (40MVA) : NS Skenderaj: zëvendësimi i transformatorit TR 1 (40MVA) Vlera e projektit është 1,355,932.20, NS Gjakova 2: zëvendësimi i transformatorit TR 1 (40MVA) Vlera e projektit është 1,355,932.20**

Arsye kryesore e futjes në listën e projekteve të këtyre dy transformatorëve është mosha e tyre, ngritja e kapacitetit transformues në dy nënstationet Gjakova 2 dhe Skenderaj dhe mundësi i konvertimit të rrjetit 10 kV në 20 kV.

Në NS Gjakova 2 parashihet që të zëvendësohet transformatori TR-2, 31.5 MVA, 110/35 kV i ndërtuar në vitin 1979 me transformator 110/10(20) kV me fuqi 40 MVA.

Në të njëjtin vit 2032 në NS Skenderaj parashihet ndërrimi i transformatorit të mbetur 31.5 MVA, 110/10 kV i ndërtuar në vitin 1987 me transformator 110/10(20) kV me fuqi 40 MVA. Projekti do të mundësojë konvertimin e plotë të rrjetit 10 kV në 20 kV duke reduktuar ndjeshëm humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe duke krijuar siguri të furnizimit për konsumin e rajonit të Skenderajt.

Figura 8. Zëvendësimi i transformatorit TR-1 në NS Gjakova 2 dhe TR-2 në NS Skenderaj



Përfitimet e pritshme nga dy projektet e lartpërmendura janë:

Reduktimi i energjisë së padërguar te konsumatorët e zonës së Gjakovës dhe Skenderaj.

Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit te konsumit të shpërndarjes

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 29</i>

Përkrahje për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjetit të shpërndarjes 10(20) kV dhe reduktimit të humbjeve në rrjet

Ngritja e kapaciteteve transformuese 110/TM kV

Përkrahje për zhvillim të sektorit ekonomik/ngarkesës industriale

Përkrahje e BRE-ve në lidhje të mundshme në rrjetin e tensionit të mesëm

- **Digjitalizimi i Operatorit të Tregut**

Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Tregut të Energjisë Elektrike (EMMS) paraqet një hap strategjik dhe të domosdoshëm për modernizimin e sektorit energjetik në Kosovë dhe për zhvillimin e një tregu transparent dhe konkurrues të energjisë elektrike. Ky projekt mbështet drejtpërdrejt objektivat e KOSTT-it si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Operator i Tregut, si dhe është në linjë me prioritetet e BERZH-së për përsheptimin e tranzicionit digjital dhe zvogëlimin e hendekut digjital në ekonominë ku BERZH investon.

Aktualisht, operimi i tregut të energjisë elektrike dhe shkëmbimi i të dhënave ndërmjet palëve të interesit mbështeten kryesisht në procese manuale, si përdorimi i Excel-it dhe shkëmbimi i të dhënave përmes emailit. Këto praktika krijojnë joefikasitet të konsiderueshëm operacional, rrisin rrezikun e gabimeve, vonesave, si dhe kufizojnë ndjeshëm aftësinë për analiza të avancuara dhe vendimmarrje strategjike. Si pasojë, menaxhmenti i lartë shpesh përballët me të dhëna të papërpunuara dhe të fragmentuara të cilat nuk mbështesin vendime të mirë informuara dhe të orientuara drejt zhvillimit afatgjatë të tregut.

Në kontekstin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, nevoja për një platformë digjitale të integruar bëhet edhe më kritike. EMMS do të shërbejë si një shtyllë e rëndësishme për funksionimin e tregut të liberalizuar, duke mundësuar automatizimin dhe centralizimin e mbledhjes, validimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave të tregut. Kjo do të sigurojë qasje të barabartë dhe në kohë reale në informacione relevante për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, përfshirë prodhuesit, furnizuesit, tregtarët, operatorët e ruajtjes, operatorin e shpërndarjes dhe rregullatorin.

Përmes EMMS, KOSTT do të jetë në gjendje të ofrojë monitorim në kohë reale të aktiviteteve të tregut, panele kontrolli (dashboards) me tregues kyç të performancës (KPI), si dhe analiza të trendeve të tregut. Kjo do të rrisë ndjeshëm transparencën dhe parashikueshmërinë, do të forcojë konkurrencën dhe do të kontribuojë në stabilitetin e tregut. Njëkohësisht, sistemi do të

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 29</i>

integroj kërkesat rregullative dhe rregullat e tregut, duke mundësuar mbikëqyrje efektive, raportim të automatizuar dhe llogaridhënie më të lartë ndaj ZRRE-së.

Përfitimet e projektit shtrihen përtej teknologjisë. EMMS do të kontribuoj në ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin e një vendim-marrje të mbështetur në të dhëna dhe analiza të mirëfillta. Për më shumë, përmes trajnimeve të fokusuara dhe zhvillimit profesional, stafi do të filloj të performoj detyra më analitike, strategjike dhe të orientuara në formësimin e politikave zhvillimore të tregut. Kjo do të rrisë efikasitetin organizativ, cilësinë e vendimmarrjes dhe aftësinë për parashikim dhe planifikim afatgjatë. Vlera e projektit është; 997,457.63 €

Në fund, duke marrë parasysh rolin rajonal të KOSTT-it dhe ndërlidhjen e rrjetit të transmetimit me vendet fqinje, EMMS duhet të projektohet në mënyrë që të mbështesë ndërveprimin rajonal dhe integrimin gradual në tregun e përbashkët të energjisë elektrike të Bashkimit Evropian. Ky projekt do të vendosë themele të forta për një treg modern, të qëndrueshëm dhe të integruar, duke kontribuar në rritjen ekonomike, sigurinë energjetike dhe zhvillimin afatgjatë të Kosovës.

Sipas legjislacionit primarë dhe sekondarë që mbulon fushën e tarifave dhe rregullimit projektet kapitale duhet të aprovohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Projektet e pakos e cila është objekt i negociatave në mes të KOSTT dhe EBRD nuk janë të aprovuara nga ZRrE për shkak se Planit Investiv Pesëvjeçarë 2023-2027 është aprovuar para fillimit të këtyre negociatave. Mirëpo, të njejtat janë pjesë e Planit Zhvillimor të Transmetimit 2024-2033, i cili dokument është i aprovuar nga ZRrE dhe i cili është bazë për përpilimin dhe aprovimin e Planit Investiv 2028-2032.

Për shkak të rëndësisë e veçantë të këtyre projekteve KOSTT, në dy proceset e fundit të Shqyrtimeve Vjetore ka bërë kërkesë të veçantë në ZRrE për aprovimin e pakos së projekteve dhe përfshirjen e tyre në Planin Zhvillimor dhe Investiv Pesëvjeçarë 2023-2027, mirëpo për shkak se përfundimi dhe hyrja në funksion e tyre parashikohet pas vitit 2027, pra jashtë periudhës aktuale rregullative, kjo kërkesë nuk është shqyrtuar.

Megjithatë, ZRrE në letrën e drejtuar EBRD-së me datë 19 mars 2024 thotë: “...ZRrE përmes kësaj shkrese konfirmon BERZH-in se se projektet e listuara më lart janë të parapara dhe të aprovuara nga Bordi i ZRrE në Planin Zhvillimor Dhjetëvjeçarë të KOSTT për periudhën 2024-20233 dhe thekson se nëse realizimi i tyre kryhet më herët, ZRrE konform mandatit të saj do t’i shqyrtoj këto investime kapitale dhe do t’i merr parasysh në proceset e ardhshme tarifore.”

Duke u bazuar në sa u tha më lart, na aspekti rregullativ nuk shihet ndonjë pengesë për vazhdimin dhe përfundimin e procesit të negociatave për huamarrje me EBRD

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 29</i>

- **Punimi i konstruksionit metalik për mbrojtje të GIS-it në NS 110kV Palaj**

NS Palaj është një ndër nënstacionet më të rëndësishme në aspektin e furnizimit elektroenergjetik. Në pjesën primare, në anën 110kV, ai ndërlidhet me linjat transmetuese dhe nënstacionet: LP 1801 NS Kosova A, LP 163/1 NS Kosova A dhe LP 163/2 NS Ilirida.

Për shkak të ngarkesave të larta dhe kërkesave për siguri të furnizimit me energji elektrike, në këtë Nënstacion janë të instaluar tre transformatorë energjetikë me transformim tensioni 110/35/10 kV, përmes të cilëve furnizohet Miniera e Bardhit të Madh (Mihja). Kjo minierë siguron furnizimin me thëngjill për TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Ky Nënstacion është ndërtuar në vitin 2012 nga KEK, ndërsa në vitin 2013, me vendim të Qeverisë, të gjitha nënstacionet 110kV kanë kaluar në pronësi të KOSTT.

Sistemi i pajisjeve primare është i ndërtuar me një sistem të mbyllur GIS (Gas Insulated Switchgear) i cili realizon izolimin dhe shuarjen e harqeve elektrike përmes gazit SF₆.

Problemi me rrjedhjen e gazit SF₆ në fushën e LP 1801 ka filluar në muajin korrik 2024. Ekipet e mirëmbajtjes së Nënstacioneve kanë ndërhyrë disa herë, duke realizuar incizime dhe matje detale përmes detektorëve përkatës. Gjithashtu, janë bërë përpjekje për eliminimin e rrjedhjeve duke përdorur materiale izoluese të ngurta dhe duke shtrënguar pllakat përmes bulonave nga ana e jashtme, me qëllim pamundësimin e rrjedhjes së gazit SF₆. Megjithatë, këto masa nuk kanë rezultuar të suksesshme dhe rrjedhja ka vazhduar.

Si pasojë, mbushja me gaz SF₆ është bërë në mënyrë të vazhdueshme, rreth një herë në javë, nga ekipet e mirëmbajtjes së Nënstacioneve.

Duke pasur parasysh se gazi SF₆ është i dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe njëkohësisht kontribuon ndjeshëm në ndotjen e mjedisit, kjo rrjedhje duhet të evitohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Heksafluoridi i squfurit (SF₆) është një gaz inorganik, i pangjyrë, pa erë, jo i ndezshëm, jashtëzakonisht i fuqishëm si gaz serrë dhe një izolues shumë i mirë elektrik. Ai është një molekulë hipervalente, tipike për një gaz jopolar, pak i tretshëm në ujë, por mjaft i tretshëm në tretës organikë jo polarë. Gazi SF₆ ka një dendësi prej 6.12 g/L në kushtet e nivelit të detit, dukshëm më të lartë se dendësia e ajrit (1.225 g/L). Indikacionet që mund të shfaqen te personeli i mirëmbajtjes në rast ekspozimi ndaj gazit SF₆ përfshijnë: kontakt me lëkurën, kontakt me sytë, gëlltitje aksidentale. Në raste të tilla, duhet të kërkohet trajtim i menjëhershëm mjekësor.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 29</i>

Bazuar në gjetjet e Komisionit Profesional të KOSTT, lidhur me problemet e identifikuar në këtë Nënstacion, rekomandohet që pajisjet ekzistuese të sistemit GIS 110 kV në NS Palaj të mbulohen me panele të izoluar, me qëllim:

- rritjen e jetëgjatësisë së pajisjeve,
- mbrojtjen nga ndotjet e jashtme,
- mbrojtjen nga kushtet atmosferike gjatë dimrit dhe verës,
- reduktimin e ndikimit të pluhurit dhe ndotjeve fizike.

Ndotja në lokacionin ku ndodhen pajisjet GIS në NS Palaj është jashtëzakonisht e lartë, pasi Nënstacioni gjendet pranë minierave të thëngjillit dhe shumë afër deponisë së mbeturinave. Për këtë arsye, ky mbulim konsiderohet i domosdoshëm edhe nga aspekti i sigurisë operationale.

Për realizimin e kësaj zgjidhjeje është përgatitur kërkesa për buxhet në planifikimin e ri financiar.

Vlera e projektit është: 150,000.00€.

Në vijim paraqiten fotot e sistemit GIS.



Foto 1 dhe 2- Pamja e jashtme e sistemit te GIS ana 110kV

• **Furnizim me nënstacion mobil**

Në vitet e fundit, sistemi elektroenergjetik i Republikës së Kosovës është përballur me rritje të vazhdueshme të kërkesës për energji elektrike, si rezultat i zhvillimeve ekonomike, urbanizimit dhe

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 29</i>

rritjes së konsumit energjetik. Kjo rritje e kërkesës ka reflektuar drejtpërdrejt në shtimin e ngarkesave në nënstacionet ekzistuese të KOSTT, veçanërisht në nivelet e tensionit 110/35/10(20) kV, të cilat përbëjnë një kritikë të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes.

Duke marrë parasysh infrastrukturën aktuale të KOSTT, numrin e nënstacioneve në operim, numrin e kufizuar të transformatorëve të fuqisë dhe mungesën e transformatorëve rezervë si asete strategjike dhe me vlerë shumë të lartë financiare, sistemi mbetet i ekspozuar ndaj rreziqeve operative në rast të defekteve të papritura, avarive teknike apo ndërhyrjeve të planifikuara për mirëmbajtje.

Në praktikën bashkëkohore të sistemeve elektroenergjetike të ngjashme me KOSTT, një zgjidhje e shpejtë, efikase dhe tekniko-ekonomikisht e arsyeshme për menaxhimin e këtyre rreziqeve është përdorimi i nënstacioneve mobile. Këto njësi mundësojnë zëvendësim të përkohshëm të transformatorëve të fuqisë ose të nënstacioneve të dëmtuara, duke garantuar vazhdimësi të furnizimit me energji elektrike, reduktim të kohës së ndërprerjeve dhe rritje të sigurisë operative të sistemit.

Furnizimi i KOSTT me një nënstacion mobil për nivelin e tensionit 110/35/10(20) kV paraqitet si një nevojë e domosdoshme strategjike. Ky nënstacion do të shërbente si aset rezervë për raste emergjente, për mbulimin e ngarkesave kritike dhe për mbështetjen e punimeve të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit në nënstacionet ekzistuese.

Bazuar në analizat teknike dhe vlerësimet e tregut, kostoja e një nënstacioni mobil të këtij niveli vlerësohet rreth 3,000,000.00 euro, ku përfshihet transformatori i fuqisë, fushat e tensionit të lartë dhe të mesëm, pajisjet mbrojtëse dhe komandues, si dhe integrimi i plotë i të gjitha komponentëve në një platformë mobile (rimorkio).

Si përfundim, investimi në një nënstacion mobil 110/35/10(20) kV është i arsyetuar teknikisht dhe ekonomikisht, dhe përfaqëson një masë të rëndësishme për rritjen e besueshmërisë, fleksibilitetit dhe sigurisë së operimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës. Vlera e projektit është; 3,000,000.00€.

- **Rindërtimin e Linjës Kabllore 6.3kV NS Kosova B-TC Kosova B**

NS Kosova B përfaqëson një nga nyjet më kritike të sistemit elektroenergjetik të Kosovës, pasi përveç linjave interkonektive, në këtë nënstacion janë të lidhur edhe dy gjeneratorët kryesorë të TC Kosova B (Gjeneratori B1 dhe Gjeneratori B2). Funksionimi i qëndrueshëm dhe i pandërprerë i këtij nënstacioni është thelbësor për sigurinë dhe stabilitetin e sistemit elektroenergjetik në tërësi.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 29</i>

Për nevojat e furnizimit vetanak, NS Kosova B është projektuar të furnizohet me tension 6.3 kV përmes dy linjave kabllore të ndara: njëra nga TC Kosova B dhe tjetra nga TC Kosova A, me qëllim sigurimin e redundancës dhe besueshmërisë së furnizimit. Megjithatë, linja 6.3 kV nga NS Kosova A ka rezultuar jostabile për shkak të problemeve të vazhdueshme teknike në pjesën ku është e lidhur njësia e Azotikut, si dhe për shkak të gjendjes së rëndë të pajisjeve në TC Kosova A. Duke qenë se nuk ekziston një plan konkret për rehabilitimin e këtyre pajisjeve, kjo linjë nuk është konsideruar burim i sigurt furnizimi.

Si pasojë, për një periudhë të gjatë kohore, NS Kosova B është furnizuar pothuajse ekskluzivisht nga TC Kosova B përmes linjës së dytë kabllore 6.3 kV. Në muajin korrik të vitit 2025 kanë filluar të shfaqen defekte serioze në këtë linjë kabllore, të cilat janë përsëritur pavarësisht ndërhyrjeve të shumta teknike deri në muajin nëntor të po atij viti. Pas analizave dhe intervenimeve të vazhdueshme, është konstatuar se për shkak të dëmtimeve të shumta dhe degradimit të përgjithshëm, kjo linjë nuk mund të riparohet në mënyrë që të garantojë furnizim të sigurt dhe afatgjatë për NS Kosova B.

Në këto rrethana, burimi i vetëm i mbetur për furnizimin e nënstacionit ka qenë gjeneratori dizel, i cili për shkak të natyrës së tij emergjente nuk mund të konsiderohet zgjidhje e qëndrueshme dhe ekonomike për funksionim afatgjatë. Për të shmangur rrezikun e ndërprerjes së furnizimit dhe pasojat serioze që kjo do të kishte për sistemin elektroenergjetik, është vlerësuar e domosdoshme kërkesa ndaj KEDS për realizimin e një lidhjeje emergjente dhe të përkohshme nga rrjeti i tyre.

Kjo zgjidhje do të sigurojë furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm për NS Kosova B deri në përfundimin e projektit për rindërtimin e linjës së re kabllore 6.3 kV ndërmjet NS Kosova B dhe TC Kosova B. Vlera e parashikuar e këtij projekti është 150,000.00 euro, e cila konsiderohet e arsyeshme dhe e domosdoshme duke pasur parasysh rëndësinë strategjike të nënstacionit dhe rrezikun që paraqet mungesa e furnizimit të sigurt me energji elektrike.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 29</i>

5.2 Arsyeshmëria shtesë për projekte;

Projektet të cilave ju është ndryshuar burimi i financimit

- KOSTT/KFW - Furnizimi dhe instalimi I Reaktori shant-variabil 100 MVar, 400 kV ne NS Ferizaj 2
- KOSTT/KFW - Furnizimi dhe instalimi me pajisje për adoptim te SCADA Lokale (RTU dhe SCS)
- KOSTT/KFW- Ndërrimi i Sistemit Ekzistues SCADA/EMS në QND dhe QEND
- KOSTT/KFW - Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese.

Projektet të cilat janë zavendësuar

- Zëvendësimi i transformatorit të fuqisë TR 1 në NS Theranda në NS Prishtina 5 me TR 110/10(20)kV, 40MVA, kjo për arsye se ka ndryshuar plani zhvillimor i transmisionit ndikuar nga mos investimi nga operatori i shpërndarjes keds ne linjën 35 kv në Therandë.

Projektet me rritje të vlerës

- Module shtesë dhe user licenca për NEPLAN

Me vendim e bordit 250428-II/6, janë shtuar 27,276.00 te programi Module shtesë dhe user licenca për NEPLAN, kjo me kërkesë të Operator i Sistemit sepse në planifikimet e rregullta lidhur me vazhdimin e mirëmbajtjes së softuerit NEPLAN dhe shtimin e dy moduleve të reja, ne kemi planifikuar një buxhet prej 65,000 euro (Short Circuit dhe eksporti në formatin .raw file - Kodi Buxhetor 023/109 - Vlera 17,000 euro, mirëmbajtja vjetore softueri NEPLAN për CGEMS – Kodi Buxhetor 5320/70 – Vlera 3*18,000 = 54,000 euro). Pra, punët që janë përfshirë në këtë buxhet janë mirëmbajtja e softuerit NEPLAN për 3 (tre) vitet e ardhshme si dhe shtimin e dy moduleve të reja siç janë: kalkulimi i lidhjeve të shkurta dhe mundësia e prodhimit të fajllave në versionin .raw. Po ashtu në këtë buxhet është paraparë edhe trajnimi i stafit tonë rreth këtyre moduleve të reja të NEPLAN. Kompania NEPLAN për kryerjen e këtyre detyrave ka ofertuar me çmimi pa TVSh = 78,200 euro dhe çmimi me TVSH = 92,276 euro andaj dhe është kërkuar rritje e buxhetit për vlerën 13,200 euro pa TVSh (27,276 EUR me TVSh), në mënyrë që të mundësohet kryerja e detyrave të shpjeguara më lartë, pa ndonjë pengesë eventuale që do të mund të paraqitej.

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 29</i>

Projektet që duhet larguar nga Plani Pesëvjeçar Investues i Transmetimit 2023 – 2027

- Licenca për shfrytëzim të frekuencave - ARKEP 115,254.24€
- Migrimi i sistemit të radiolidhjeve 137,237.14€

Shërbimi i komunikimit përmes radiolidhjeve është larguar nga përdorimi, rrjedhimisht KOSTT nuk ka më nevojë operative për funksionalizimin apo mirëmbajtjen e këtij sistemi. Si pasojë, nuk paraqitet nevojë për shpenzime buxhetore as për migrimin e sistemit të radiolidhjeve, pagesën e licencave të frekuencave pranë ARKEP-it, si dhe as për kostot përcjellëse që ishte qiraja për vendosjen e repetitorëve në KNNT, për sqarim, ju njoftojmë se dy vijat buxhetore janë të ndërlidhura funksionalisht me njëra-tjetrën, pasi që të dyja kanë për qëllim realizimin e komunikimit përmes radiolidhjeve.

Për këto arsye Departamentit për shërbimet përkrahëse propozon largimi i të dyja këtyre vijave buxhetore nga plani pesëvjeçar i buxhetit.

6.0 Të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026

Bazuar në Rregullën për Të Hyrat e OST/OT-së, të hyrat e lejuara maksimale do të caktohen në atë nivel që t'i mundësojnë OST/OT-së mbulimin e kostove të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve të sistemit të transmetimit dhe operimit të Tregut.

Padyshim që rritja e kërkesës për energji në Kosovë kërkon kapacitete shtesë në transmetimin e energjisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të besueshëm gjatë periudhave të kulmit të kërkesës.

KOSTT ka nevojë për mbështetje financiare për të përballuar kostot operative dhe për të zbatuar standarde të larta mjedisore dhe të sigurisë.

Tabela 6 paraqet një përmbledhje të kërkesës për të Hyrat e Lejuara Maksimale për KOSTT për vitin 2026.

Tabela 6. Aplikimi i KOSTT për MAR 2026

	APLIKACIONI PËR TARIFA	FO-ÇRT-012
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 29</i>

KOSTT MAR 2026	Njësia	2026 Aplikimi
Baza Opex	€m	9,157.650
Zhvlerësimi	€m	14,376.102
Kthimi i Lejuar	€m	11,232.660
Të hyrat jo-tarifore- alokimi	€m	(8,310.000)
ITC	€m	(206.974)
Kosto e Humbjeve	€m	14,283.053
Kostot e Shërbimeve Ndihmë	€m	46,924.095
FONDI	€m	18,675.517
Përshtatjet Për PRR2 he viti	€m	(5,421.426)
KREV	€m	(1,326.847)
FINAL MAR	€m	99,383.831

Kërkesa e KOSTT për të hyrat e lejuara maksimale për vitin 2026, në vlerën prej 99,383,831.20 euro, synon të sigurojë operim të qëndrueshëm të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, të ofrojë shërbime më cilësore për konsumatorët dhe të ruajë stabilitetin financiar të KOSTT-it. Vlen të theksohet se vlera e parashikuar e shpenzimeve operative (OPEX) është bazuar në realizimin aktual për vitin 2025.

Duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimeve në sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat e ENTSO-E, është me rëndësi jetike mbështetja e projekteve të reja, ndryshimet në projektet ekzistuese, si dhe kërkesat për shpenzime operative.

KOSTT ka paraqitur të gjitha të dhënat lidhur me realizimet dhe parashikimet e kostove për vitet 2025 dhe 2026, me shpresën që të gjitha kërkesat dhe sqarimet e paraqitura do të merren parasysh dhe do të përfshihen në të hyrat e lejuara maksimale.

Bashkëngjitur do të përcillen formularët raportues të ZRrE të plotësuar sipas kërkesës.

- Fundi i Dokumentit -